96. Nuk janë të barabartë prej besimtarëve ata, të cilët ndejtin (nuk bëjnë xhihad) - pos invalidëve - dhe ata, të cilët me pasurinë e me jetën e tyre bëjnë xhihad në rrugën e Allahut. Allahu i gradoi një shkallë më lart ata që banë xhihad (në rrugën e Allahut) me pasurinë e me jetën e tyre mbi ata, të cilët rrinë të ulur (mbrapa). Por, secilit Allahu i premtoi mirësi. Dhe Allahu i gradoi me një shpërblim të madh ata, të cilët bëjnë xhihad (në rrugën e Tij).

(Sure Al-Nisa 96)

يَعْتَدِهِ مِنَ اللَّهِ فَاسْتَبَشِرُوا بِنَيْبِكُمُ الَّذِي
بَايَعْتُمْ بِهِ وَذَلِكَ هُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ

التوبة: ١١١

لَا يَسْتَوِي الْقَاعِدُونَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ غَيْرَ أُولِي الضَّرَرِ
وَالْمُجَاهِدُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ فَضَّلَ
اللَّهُ الْمُجَاهِدِينَ بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ عَلَى الْقَاعِدِينَ
دَرَجَةً وَلَا وَعَدَ اللَّهُ الْخَسَنَ وَفَضَّلَ اللَّهُ الْمُجَاهِدِينَ
عَلَى الْقَاعِدِينَ أَجْرًا عَظِيمًا

النساء: ٩٦

KUALITETI DHE KARAKTERI I BESIMTARËVE

Kurani shpjegon nevojën e besimit në një Zot dhe tërheq vëmendjen kah argumentet rreth ekzistencës së Tij. Ai flet me theks se Zoti përherë e zbrit Fjalën e Tij me anë të diktimit (inspirimit). Po të ndalet Zoti t'i manifestojë atributet e Veta me anë të profetëve e të ndjekësve të tyre, besimi në ekzistencën e Zotit do të zhdukej. Prandaj, është e domosdoshme që diktimi Hyjnor, derisa ekziston njerëzimi, të zbresë mbi disa prej tyre.

64. Dhe robërit e vërtetë të Zotit të Mëshirshëm ata, të cilët ecin qetësisht nëpër tokë, dhe kur u drejtohen injorantë (me fjalë të ndyta), ata thonë: 'qofshit paqe!'

وَعِبَادُ الرَّحْمَنِ الَّذِينَ يَمْشُونَ عَلَى الْأَرْضِ هَوْنًا
وَإِذَا خَاطَبَهُمُ الْجَاهِلُونَ قَالُوا سَلَامًا ﴿٦٤﴾

65. Dhe të cilët për hir të Zotit të tyre natën e kalojnë duke i bërë sexhde dhe duke qëndruar këmbë (falen tërë natën)

وَالَّذِينَ يَبِيتُونَ لِرَبِّهِمْ سُجَّدًا وَقِيَامًا ﴿٦٥﴾

66. Dhe të cilët thonë: O Zoti ynë, largoe prej nesh dënimin e xhehenemit se dënimi i tij është shkatërrimi i madh

وَالَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا اصْرِفْ عَنَّا عَذَابَ جَهَنَّمَ
إِنَّ عَذَابَهَا كَانَ غَرَامًا ﴿٦٦﴾

67. Ai, më të vërtetë, është vendqëndrim (vend i përkohëshëm) e vendbanim (vend i përherëshëm) i keq -

إِنَّهَا سَاءَتْ مُسْتَقَرًّا وَمُقَامًا ﴿٦٧﴾

68. Dhe të cilët kur shpenzojnë, nuk teprojnë e as nuk dalin dorështrënguar. por e adoptojnë rrugën e mesme

وَالَّذِينَ إِذَا أَنفَقُوا لَمْ يُسْرِفُوا وَلَمْ يَقْتُرُوا وَكَانَ
بَيْنَ ذَلِكَ قَوَامًا ﴿٦٨﴾

KUALITETI DHE KARAKTERI I BESIMTAREVE

69. Dhe ata janë të tillë që nuk e thërrasin zotin tjetër, përveç Allahut, dhe që nuk e vrasin ndonjë person vrasjen e të cilit Allhu bëri të ndaluar-përveç se e kërkon e drejta ligjore, dhe që nuk bëjnë kurvërinë. Dhe kush bënë këtë akt, do ta shijojë ndëshkimin e mëkatit të tij;

وَالَّذِينَ لَا يَدْعُونَ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ وَلَا يَقْتُلُونَ
النَّفْسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ وَلَا يَزْنُونَ
وَمَنْ يَفْعَلْ ذَلِكَ يَلْقَ أَثَامًا ﴿٦٩﴾

70. Dhe do të shumëzohet për të ndëshkimi në Ditën e Kiametit, dhe ai do të jetojë në të me poshttrim

يُضَاعَفْ لَهُ الْعَذَابُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَيَخْلُدْ فِيهِ
مُهَانًا ﴿٧٠﴾

71. Pos atyre, të cilët bëjnë metani dhe e pranojnë besimin, dhe bëjnë vepra të mira. Sa u përketë këtyre, Allahu do t'i shndërrojë veprat e tyre të këqia në ato të mira, dhe Allahu fal shumë dhe është i Mëshirëshëm.

إِلَٰمَن تَابَ وَءَامَنَ وَعَمِلَ عَمَلًا صَالِحًا
 فَأُولَٰئِكَ يُبَدِّلُ اللَّهُ سَيِّئَاتِهِمْ حَسَنَاتٍ وَكَانَ اللَّهُ
عَفُورًا رَحِيمًا ﴿٧١﴾

72. Dhe ai, i cili e bën metani dhe bën vepra të mira, më të vërtetë, i drejtohet Allahut me pendesë të vërtetë,

وَمَنْ تَابَ وَعَمِلَ صَالِحًا فَإِنَّهُ يَتُوبُ إِلَى اللَّهِ
مَتَابًا ﴿٧٢﴾

73. Dhe ata, të cilët nuk japin dëshmi të rrejshme, dhe të cilët kur kalojnë pranë llomotitje, kalojnë me dinjitet,

وَالَّذِينَ لَا يَشْهَدُونَ الزُّورَ وَإِذَا مَرُّوا بِاللَّغْوِ
مَرُّوا كِرَامًا ﴿٧٣﴾

74. Dhe ata, të cilët kur u kujtohen Shenjat e Allahut të tyre, nuk sillen ndaj tyre si të shurdhër e të verbër.

وَالَّذِينَ إِذَا ذُكِرُوا بِآيَاتِ رَبِّهِمْ لَمْ يُخِرُّوا
عَلَيْهَا صُمًّا وَعُمْيَانًا ﴿٧٤﴾

75. Dhe ata, të cilët thonë, 'Zoti ynë, na dhuro gëzim dhe qetësim nga ana e grave dhe e fëmijëve tanë dhe bëna shembull (model) për njerëzit e dëlirë,

وَالَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا
وَذُرِّيَّتِنَا قُرَّةَ أَعْيُنٍ وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ
إِمَامًا ﴿٧٥﴾

76. Të këtyrë janë ata, të cilëve do t'u jepen oda madhështore në Parajsë, sepse kanë dalë të qëndrueshëm në rrugën e bamirësisë dhe do të priten në të me përshëdetje e me nderim,

أُولَٰئِكَ يُجْزَوْنَ الْغُرْفَةَ بِمَا صَبَرُوا
وَيُلْقَوْنَ فِيهَا حَيَّةً وَسَلَمًا ﴿٧٦﴾

KUALITETI DHE KARAKTERI I BESIMTAREVE

77. Do të jetojnë në të. Ajo Parajsja është vend i shkëlqyeshëm për banim të përkohshëm dhe për banim të përhershëm.

خَالِدِينَ فِيهَا حَسَنَتْ مُسْتَقَرًّا وَمُقَامًا ﴿٧٧﴾

78. (O profet) Thuaju mosbesimtarëve, ‘Zoti im s’është aspak për ju nëse s’bëni lutje e s’bëni falje. Por, meqenë se e keni përgënjeshtruar mesazhin e Tij, ndëshkimi i Tij do t’ju rrethojë.

قُلْ مَا يَعْزُبُ عَنْ رَبِّي لَوْلَا دُعَاؤُكُمْ فَقَدْ كَذَّبْتُمْ فَسَوْفَ يَكُونُ لَكُمْ آثَامًا ﴿٧٨﴾

الفرقان: ٦٤ - ٧٨

(Sure Al-Furkan, ajët 64-78)

2. Padyshim, ngadhnohen besimtarët e vërtetë,

قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ ﴿٢﴾

3. Të cilët e shprehin përlësinë në namazet e tyre

الَّذِينَ هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَاشِعُونَ ﴿٣﴾

4. Dhe të cilët u shmangen fjalëve të kota,

وَالَّذِينَ هُمْ عَنِ اللَّغْوِ مُعْرِضُونَ ﴿٤﴾

5. Dhe të cilët paguajnë rregullisht zekatin,

وَالَّذِينَ هُمْ لِلزَّكَاةِ فَاعِلُونَ ﴿٥﴾

6. Dhe të cilët i ruajnë vendet e tyre të turpshme,

وَالَّذِينَ هُمْ لِفُرُوجِهِمْ حَافِظُونَ ﴿٦﴾

7. Pos prej grave të tyre ose prej atyre robëreshave që i posedojnë duart e tyre të djathta, sepse të tillë nuk do të akuzohen,

إِلَّا عَلَىٰ أَرْوَاحِهِمْ أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُمْ فَإِنَّهُمْ غَيْرُ مَلُومِينَ ﴿٧﴾

8. Por, ata, të cilët kërkojnë diçka tjetër pos kësaj, teprojnë,

فَمَنْ أَتَّبَعِيَ وَرَاءَ ذَلِكَ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْعَادُونَ ﴿٨﴾

9. Dhe të cilët janë të kujdesshëm ndaj amaneteve të tyre dhe ndaj konventave të tyre,

وَالَّذِينَ هُمْ لِأَمَانَاتِهِمْ وَعَهْدِهِمْ رَاعُونَ ﴿٩﴾

10. Dhe të cilët janë të përpikët ndaj namazeve të tyre,

وَالَّذِينَ هُمْ عَلَىٰ صَلَوَاتِهِمْ يُحَافِظُونَ ﴿١٠﴾

11. Të tillë janë trashëgimtarë të denjë,

أُولَٰئِكَ هُمُ الْوَارِثُونَ ﴿١١﴾

12. Të cilët do ta trashëgojnë Parajsën, ku do të banojnë përgjithmonë.

الَّذِينَ يَرِثُونَ الْفِرْدَوْسَ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿١٢﴾

(Sure Al-Momenun, ajët 2-12)

المؤمنون: ٢ - ١٢

TË DREJTAT E BARABËRTA PËR MESHKUJT E PËR FEMRAT

Para ardhjes së Islamit grat, si një klase, nuk kishin të drejtat ligjore. Islami është ai religjion i vetëm, i cili e stabilizon trupin perfekt të parimeve - duke ua dhënë grave mbrojtjen e të drejtave të tyre, duke i bërë të barabërta me meshkujt në të dyja sferat e jetës shpirtërore dhe fetare, duke ua dhënë një pozitë të pavarur, duke ua dhënë të drejtat e pronësisë dhe duke i bërë përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre një pjesë të ligjit Hyjnor.

98. Kush duke qenë besimtar bën vepra të mira, qoftë është mashkull apo është femër, Ne me siguri do t'ia japim një jetë të pastër; dhe Ne do t'ua japim njerëzve shpërblimin e tyre sipas veprave të tyre të mira.

(Sure Al-Nahal, ajet 98)

125. Kush bën ndonjë vepër të mirë - qoftë është mashkull apo femër - duke qenë besimtarë, të tillë do të hyjnë në xhenet dhe nuk do t'u bëhet fare padrejtësia.

(Sure Al-Nisa, ajet 125)

36 Vërtetë, meshkujt e bindur (para Allahut) dhe grat e bindura, dhe besimtarët dhe besimtares, dhe meshkujt e dëgjueshëm dhe grat e dëgjueshme, dhe meshkujt e vërtetë dhe grat e vërteta, dhe durimtarët dhe durimtares, dhe meshkujt e përlushëm dhe grat e përlushme, dhe meshkujt që japin lëmoshat dhe grat që japin lëmoshat, dhe meshkujt që agjërojnë dhe grat që agjërojnë, dhe meshkujt që i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre

مَنْ عَمِلَ صَالِحًا مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ أَنثَىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ
فَلَنَجْزِيَنَّهُ حَيٰوةً طَيِّبَةً وَلَنَجْزِيَنَّهُمْ أَجْرَهُمْ
بِأَحْسَنِ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٩٨﴾

النحل: ٩٨

وَمَنْ يَعْمَلْ مِنَ الصَّالِحَاتِ مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ
أُنْثَىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَأُولَٰئِكَ يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ وَلَا
يُظَلَمُونَ شَيْئًا ﴿١٢٥﴾

النساء: ١٢٥

إِنَّ الْمُسْلِمِينَ وَالْمُسْلِمَاتِ وَالْمُؤْمِنِينَ
وَالْمُؤْمِنَاتِ وَالْقَنِينَ وَالْقَنِينَ وَالصَّادِقِينَ
وَالصَّادِقَاتِ وَالصَّابِرِينَ وَالصَّابِرَاتِ وَالْخَشِيعِينَ
وَالْخَشِيعَاتِ وَالْمُتَصَدِّقِينَ وَالْمُتَصَدِّقَاتِ
وَالْحَافِظِينَ وَالْحَافِظَاتِ

TE DREJTAT E BARABERTA

dhe grat që i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, dhe meshkujt që e përkujtojnë shumë Allahun dhe grat që e përkujtojnë shumë Allahun për të gjithë këta Allahu ka përgaditur falje dhe një shpërblim të madh.

(Sure Al-Ahzab, ajete 36)

41. Kush do të bëjë vepër të keqe, do të shpërblehet sipas asaj që ka bërë, por kush do të bëjë vepër të mirë, qoftë është mashkull apo femër, dhe është besimtar i vërtetë - të tillë do të hyjnë në xhenet ku do të shpërblehen pamasë;

(Sure Al-Momin, ajete 41)

229. Dhe gra të divorcuara duhet të presin tri menstruacione dhe duhet të dinë - po se kanë besim në Allah e në Ditën e Fundit - se nuk u lejohet ta fshehin atë që Allahu ka krijuar në mitrat e tyre; dhe burrat e tyre - nëse dëshirojnë të pajtohen me to - gjatë asaj kohe kanë të drejtë t'i marrin prapë. Dhe ato kanë do të drejta si kanë meshkujt, mirëpo meshkujve u takon një përparësi ndaj tyre. Dhe Allahu është i Plotfuqishëm dhe i urtë.

230. Divorci i tillë (pas të cilit mund të bëhet kthimi) bëhet dy herë e mandej duhet ta mbash atë apo ta përcjellësh në mënyrë të njerëzishme. Dhe nuk ju lejohet (o burra) të merrni asnjë send nga ajo që u keni dhuruar, vetëm nëse ata të dy (burri e grua) frikësohen se nuk do të mund t'i ruajnë kufijt e Allahut. Pra, nëse keni frikë se ata nuk do t'i ruajnë kufijt e Allahut, atëherë nëse ajo grua fal diçka si kompenzim, ata të dy nuk do të kenë mëkat. Këta janë kufijt e Allahut, pra mos i kaloni. Dhe kush i tejkalon kufijt e Allahut, të tillë janë mizorë (i bëjnë dëm vetes).

(Sure Al-Bakara 229-230)

فَرُوحَهُمْ وَالْحَفِظَاتِ وَالذَّاكِرِينَ اللَّهَ
كَثِيرًا وَالذَّاكِرَاتِ أَعَدَّ اللَّهُ لَهُمْ مَغْفِرَةً
وَأَجْرًا عَظِيمًا ﴿٣٦﴾

الأحزاب: ٣٦

مَنْ عَمِلَ سَيِّئَةً فَلَا يُجْزَى إِلَّا مِثْلَهَا وَمَنْ عَمِلَ
صَالِحًا مِنْ ذَكَرٍ أَوْ أُنْثَىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ
فَأُولَٰئِكَ يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ يُرْفَعُونَ فِيهَا بِعَبَائِرِ

حِسَابٍ ﴿٤١﴾

المؤمن: ٤١

وَالْمُطَلَّقَاتِ يَتَرَبَّصْنَ بِأَنفُسِهِنَّ ثَلَاثَةَ قُرُوءٍ وَلَا
يَحِلُّ لَهُنَّ أَنْ يَكْتُمْنَ مَا خَلَقَ اللَّهُ فِيهِ أَرْحَامَهُنَّ إِنْ كُنَّ
يُؤْمِنْنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ يُوْعَلُونَ لَهُنَّ أَجْرٌ بِرِزْقِهِنَّ فِي ذَلِكَ
إِنْ أَرَادُوا إِصْلَاحًا وَلَهُنَّ مِثْلُ الَّذِي عَلَيْهِنَّ بِالْمَعْرُوفِ
وَاللِّرِّجَالِ عَلَيْهِنَّ دَرَجَةٌ وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٢٢٩﴾

الطَّلُوقِ مَرَّتَانٍ فَإِمْسَاكٌ بِمَعْرُوفٍ أَوْ تَسْرِيحٌ
بِإِحْسَانٍ وَلَا يَحِلُّ لَكُمْ أَنْ تَأْخُذُوا بِمَا
ءَاتَيْتُمُوهُنَّ شَيْئًا إِلَّا أَنْ يَخَافَا أَلَّا يُقِيمَا حُدُودَ
اللَّهِ فَإِنْ خِفْتُمْ أَلَّا يُقِيمَا حُدُودَ اللَّهِ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِمَا
فِيهَا أَنْفَدَتْ بِهِنَّ تِلْكَ حُدُودَ اللَّهِ فَلَا تَعْتَدُوهَا وَمَنْ
يَعْتَدْ حُدُودَ اللَّهِ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٢٣٠﴾

﴿٢٣٠﴾

NDALIMI I PËRDORIMIT TË KAMATËS

Fjala që është përdorur në Kuran lidhur me kamatën, është *Riba*, kuptimi i së cilës nuk është identik me *kamatën* siç kuptohet zakonisht. *Riba* është ndaluar përshtak se kjo lejon që pasuria të sillet vetëm në duart e disa personave të shoqërisë dhe i pengon njerëzit tjerë të fitojnë dobi nga ato pasuritë. Në rast borxhi që e bart kamatën, huadhënësi faktikisht përfiton dobi nga nevoja e nga mjerimi i të tjerëve.

276. Ata, të cilët e hanë kamatën, ngriten ashtu si ngritet ai i çmenduri nga të prekurit e shejtanit. Kështu ndodh për shkak se ata thonë se 'edhe shitblerja është si kamata.' Mirëpo, Allahu e bëri të lejueshme shitblerjen dhe e bëri të ndaluar kamatën. Dhe ai që e ndal veten (nga përdorimi i kamatës) pasi që i erdh këshillë prej Zotit të tij, atëherë atij i takon çka kish bërë në të kaluarën dhe çështja e tij mbetet te Allahu. Por, ata që e përsërisin (pas ndalimit), janë banorë të xhehenemit dhe aty do të jetojnë përgjithmonë.

277. Allahu do ta zhdukë kamatën dhe do t'i shtojë lëmoshat, dhe Allahu nuk e do çdo mosbesimtar të prerë dhe mëkatar të madh.

278. Vërtetë, ata, të cilët e pranojnë besimin dhe bëjnë vepra të mira dhe falin namazin e paguajnë zekatin, do të kenë shpërblimin e tyre te Zoti i tyre; ata nuk do të kenë as frikë (për të ardhmen) e as nuk do të pikëllohen (për të kaluarën).

الَّذِينَ يَأْكُلُونَ الرِّبَا لَا يَقُومُونَ إِلَّا كَمَا
يَقُومُ الَّذِي يَتَخَبَّطُهُ الشَّيْطَانُ مِنَ الْمَسِّ ذَلِكَ
بِأَنَّهُمْ قَالُوا إِنَّمَا الْبَيْعُ مِثْلُ الرِّبَا وَأَحَلَّ اللَّهُ
الْبَيْعَ وَحَرَّمَ الرِّبَا فَمَنْ جَاءَهُ مَوْعِظَةٌ مِنْ رَبِّهِ
فَأَنْهَىٰ قَلْبَهُ مَأْسَلَفَ وَأَمْرُهُ إِلَى اللَّهِ وَمَنْ
عَادَ فَأُولَٰئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ هُمْ فِيهَا
خَالِدُونَ ﴿٢٧٦﴾

يَمْحَقُ اللَّهُ الرِّبَا وَيُرِي الصَّدَقَتِ وَاللَّهُ لَا
يُحِبُّ كُلَّ كَفَّارٍ أَثِيمٍ ﴿٢٧٧﴾

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَأَقَامُوا
الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ لَهُمْ أَجْرُهُمْ عِنْدَ
رَبِّهِمْ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿٢٧٨﴾

NBALIMI PERDORIMIT TE KAMATES

279. O ju besimtarë, frikësohuni prej Allahut dhe hiqni dorë nga ajo (kamata) që ka mbetur, nëse jeni besimtarë të vërtetë.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَذَرُوا مَا بَقِيَ مِنَ
الرِّبَا إِن كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ ﴿٢٧٩﴾

280. Dhe nëse nuk do të bëni kështu, atëherë mbani mend se jeni në konflikt me Allahun dhe me Profetin e Tij; dhe nëse pendoheni, atëherë keni të drejtë ta merrni kapitalin tuaj. Kështu nuk do ta dëmtoni askë e as nuk do të bëni dëm për vete.

فَإِن لَّمْ تَفْعَلُوا فَأْذَنُوا بِحَرْبٍ مِنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ وَإِن
تُبْتِغُوا فَلَكُمْ رُءُوسُ أَمْوَالِكُمْ لَا تَظْلِمُونَ
وَلَا تُظْلَمُونَ ﴿٢٨٠﴾

281. Dhe nëse huamarrësi është në gjendje të vështirë, atëherë duhet që t'ia jepni afat deri sa të lirohet ai. Dhe nëse ia falni në emër të lëshohës, do të jetë më mirë për ju - nëse kuptoni ju.

وَإِن كَانَتْ ذُو عُسْرَةٍ فَنَظِرَةٌ إِلَىٰ مَيْسَرَةٍ وَإِن
تَصَدَّقُوا خَيْرٌ لَّكُمْ إِن كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٢٨١﴾

282. Dhe frikësohuni prej asaj dite kur do të ktheheni të Allahut. Atëherë, secilit do t'i jepet plotësisht ajo që e kish fituar dhe nuk do t'u bëhet padrejtësia.

(Sure Al-Bakara, ajët 276-282)

وَاتَّقُوا يَوْمًا تُرْجَعُونَ فِيهِ إِلَى اللَّهِ ثُمَّ تُوَفَّىٰ كُلُّ
نَفْسٍ مَّا كَسَبَتْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿٢٨٢﴾
البقرة: ٢٧٦ - ٢٨٢

PROFECITË

Shumë kapituj të parë të diktuar të Kuranit citojnë disa fenomene të ndryshme si evidencë në përkrahjen e doktrinave themelore dhe të mësimave të Kuranit. Disa prej këtyre kapitujve përbëjnë profecitë, plotësimi i të cilave është dëshmuar gjatë shekujsh. Nga njëherë ato plotësohen letrarisht e nga njëherë kanë kuptim metaforik apo plotësohen në të dyja format. Si u tha më parë se vetë emri i Librit *Kuran* është një profeci e madhe në vete, plotësimi i së cilës u dëshmuar shekuj me radhë. Diktimi i parë paralajmëron ardhjen e kohës kur dituria mësohet me anë të përdorimit ekstensiv të penës (96:4-6).

20. Ai i ka krijuar dy dete kështu që një ditë ato do të bashkohen;

مَرَجَ الْبَحْرَيْنِ يَلْتَقِيَانِ ﴿٢٥﴾

21. Midis tyre-tani për tani-është një pengesë përshkak së cilës ato s'mund të bashkohen me njerin tjetër.

بَيْنَهُمَا بَرْخٌ لَا يَتَّعِيَانِ ﴿٢٦﴾
الرحمن: ٢٠ - ٢١

(*Sure Al-Rahman, ajet 20-21*)

34. O kompania e xhindeve dhe e njerëzve! nëse keni fuqi të dilni jashtë kufive të qiejve e të tokës, atëherë dilni. Mirëpo, mbani mend se ju s'mund të dilni pa argument.

يَمَعَشَرَّ الْجِنُّ وَالْإِنْسُ إِنِ اسْتَطَعْتُمْ أَنْ تَنْفُذُوا مِنْ أَقْطَارِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ فَانْفُذُوا ۗ لَآ تَنْفُذُونَ إِلَّا بِإِذْنِ رَبِّكُمْ

35. Pra, tregoni cilin prej favoreve të Zotit tuaj do ta mohoni ju?

فَمَا يَكْفُرُ الْآلَهُ رَبِّكُمْ أَنْتُمْ كَذِبَانِ ﴿٣٥﴾

36. Do të bjerë kundër jush një flakë zjarri dhe bakër i shkrirë dhe ju nuk do të jeni të aftë të mbrohni.

يُرْسِلُ عَلَيْكُمْ شَوَاطِيرَ مِّن نَّارٍ وَبُحَّاسٌ فَلَا تَنْصُرُونَ ﴿٣٦﴾

(*Sure Al-Rahman, ajet 34-36*)

الرحمن: ٣٤ - ٣٦

2. Kur do të pëlçet qielli,

إِذَا السَّمَاءُ انشَقَّتْ ﴿٦﴾

3. Dhe do të vëjë veshin për ta dëgjuar fjalën e Zotit të tij-dhe ky është obligim i tij

وَأَذِنَتْ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ ﴿٧﴾

PROFECITE

4. Dhe kur toka do të shtrihet (do të zbulohet se planete të ndryshme janë pjesë të tokës)
- وَإِذَا الْأَرْضُ مُدَّتْ ﴿٤﴾
5. Dhe gjithçka që është në të, do ta qesë jashtë dhe do të zbrazet,
- وَأَلْقَتْ مَا فِيهَا وَتَخَلَّتْ ﴿٥﴾
6. Dhe do të vëjë veshin për ta dëgjuar fjalën e Zotit të saj-dhe ky është obligim i saj.
- وَأَذِنَتْ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ ﴿٦﴾
- الانشقاق: ٢ - ٦
- (Sure Al-Inshekak, ajet 2-6)
5. Dhe kur devet dhjetë muaj shtatëzëna do të lëshohen,
- وَإِذَا الْعِشَارُ عُطِّلَتْ ﴿٧﴾
8. Dhe kur popuj të ndryshëm do të bashkohen,
- وَإِذَا الْثَفُؤُسُ زُوِّجَتْ ﴿٨﴾
11. Dhe kur do të shpërnadahan libra,
- وَإِذَا الصُّحُفُ نُشِرَتْ ﴿١١﴾
12. Dhe kur do të xheveshet qielli,
(Sure Al-Takvir, ajet 5-8 dhe 11-12)
- وَإِذَا السَّمَاءُ كُشِطَتْ ﴿١٢﴾
- التكوير: ١١ - ١٢
2. Kur do të shkundet toka me shkundje të ashpër,
- إِذَا زُلْزِلَتِ الْأَرْضُ زِلْزَالَهَا ﴿٢﴾
3. Dhe toka do ta hedhë barrën e saj,
- وَأَخْرَجَتِ الْأَرْضُ أَثْقَالَهَا ﴿٣﴾
4. Dhe njeriu do të thotë, 'ç'ndodhi me të!
- وَقَالَ الْإِنْسَانُ مَا لَهَا ﴿٤﴾
5. Atë ditë ajo do t'i zbulojë fshehtësitë e saj,
- يَوْمَئِذٍ تُحَدِّثُ أَخْبَارَهَا ﴿٥﴾
6. Sepse, Zoti yt ka dekretuar për të.
- بِأَنَّ رَبَّكَ أَوْحَىٰ لَهَا ﴿٦﴾
7. Atë ditë do të tubohen njerëzit në formë grupesh të ndryshme që t'i shohin rezultatet e veprave të tyre.
- يَوْمَئِذٍ يَصُدُّرُ النَّاسُ أَشْتَاتًا لَّيْرَوُا أَعْمَالَهُمْ ﴿٧﴾

PROFECITE

8. Atëherë, kush e kish bërë një bamirësi të vogël sa grima, do ta shehë atë (rezultatit e saj),

﴿٨﴾ فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ

9. Dhe kush e kish bërë një vepër të keqe sa grima, do ta shehë atë.

(Sure Al-Zilzal, ajët 2-9)

﴿٩﴾ وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ

الزلزال: ٢ - ٩

106. Dhe ata të pyesin ty rreth malesh. Thuaju, 'Zoti im do t'i bëjë hi e pluhur.'

﴿١٠٦﴾ وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الْجِبَالِ فَقُلْ يَنْسِفُهَا رَبِّي نَسْفًا

107. Dhe Ai do t'i shndërrojë ato në një fushë të shkretuar

﴿١٠٧﴾ فَيَذَرُهَا قَاعًا صَفْصَفًا

108. Ku s'do të shohësh as ndonjë kthesë e as ndonjë lartësi.

(Sure Ta-Ha, ajët 106-108)

﴿١٠٨﴾ لَا تَرَىٰ فِيهَا عِوَجًا وَلَا أَمْتًا

طه: ١٠٦ - ١٠٨

83. Dhe kur do të plotësohet profecia rreth shkatërrimit të tyre, Ne do të nxjerrim nga toka një insekt (Murtaja) që do t'i kafshojë ata përshkak se njerëzit nuk i besonin Shenjat Tona.

(Sure Al-Namal, ajët 83)

﴿٨٣﴾ وَإِذَا وَقَعَ الْقَوْلُ عَلَيْهِمْ أَخْرَجْنَا لَهُمْ دَابَّةً مِّنَ الْأَرْضِ

﴿٨٤﴾ تُكَلِّمُهُم أَنَّ النَّاسَ كَانُوا بِآيَاتِنَا لَا يُوقِنُونَ

النمل: ٨٣

8. Kur syri do të hutohet,

﴿٨﴾ فَأَذَابُكَ الْبَصَرُ

9. Dhe kur do të errësohet hëna,

﴿٩﴾ وَخَسَفَ الْقَمَرُ

10. Dhe kur dielli e hëna do të bashkohen në një gjendje (do të errëshohen bashkë).

(Sure Al-Kiamah, ajët 8-10)

﴿١٠﴾ وَجُمِعَ الشَّمْسُ وَالْقَمَرُ

القيامة: ٨ - ١٠

VËZHGIMI LIDHUR ME NATYRËN

Një ndër tiparet unike të Kuranit është se megjithkëtë fakt se ky është 1400 vjet i vjetër, nuk e përmend diçka lidhur me natyrën, të cilën e përgënjeshtrohet zbulimi i vonshëm. Ka shumë ajete që flasin rreth zbulimeve bashkëkohore shkencore, kurse ka edhe të atilla që flasin rreth disa fenomeneve, të cilat duhet të zbulohen. Këtu po japim sa për ilustrim disa ajete nga Kurani që kanë lidhje me natyrën.

30. Dhe prej Shenjave të Tij është edhe krijimi i qiejve dhe i tokës dhe i gjallesave që i ka shpërndarë në të. Dhe Ai ka fuqi t'i bashkojë të gjitha ato (krijesat) kur do të dëshirojë Ai.

(Sure Al-Shura, ajete 30)

وَمِنْ آيَاتِهِ خَلْقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا مِنْ دَابَّةٍ وَهُوَ عَلَىٰ جَمْعِهِمْ إِذَا يَشَاءُ قَدِيرٌ ﴿٣٠﴾

الشورى: ٣٠

99. Dhe Ai është Allahu, i cili ju ka krijuar prej një nefsi e mandej e bëri për ju një vendbanim të përhershëm. Ne u kemi shpjeguar hollësisht Shenjat njerëzve të kuptueshëm.

(Sure Al-Anam, ajete 99)

وَهُوَ الَّذِي أَنْشَأَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ فَمُسْتَوْفٍ وَمُسْتَوْدَعٌ

قَدْ فَصَّلْنَا الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَفْقَهُونَ ﴿٩٩﴾

الأنعام: ٩٩

2. O ju njerëz, frikësohuni prej Zotit tuaj, i cili ju ka krijuar prej një nefsi dhe nga ai krijoi palën e tij (shoqën), dhe mandej prej atyre dyve i krijoi shumë burra e gra. Dhe frikësohuni prej Allahut - në emrin e të cilit i bëni pyetje njeri-tjetrit - lidhur me marrëdhëniet farefisnore. Vërtetë, Allahu është Mbikëqyrës mbi ju.

(Sure Al-Nisa, ajete 2)

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ

رَقِيبًا ﴿٢﴾ النساء: ٢

VEZHGIMI LIDHUR ME NATYREN

7. Allahu është Ai, i cili ju krijon (trajton) në mitra ashtn si dëshiron Ai; s'ka Zot tjetër pos Atij që është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.

(Sure Al-Imran, ajet 7)

20. A nuk e sheh-o dëgjues, se Allahu i ka krijuar qiejt e tokën me urtësi? Nëse do Ai, mund t'ju shkatërrojë juve dhe ta sjellë një krijesë të re.

(Sure Ibrahim, ajet 20)

89. Dhe ti i sheh malet si të qënduara në një vend, kurse ato po ecin si retë. Kjo është vepra e Allahut, i cili çdo gjë e ka krijuar të përsosur. Vërtetë, Ai është i Vetëdëshëm ndaj asaj që bëni ju.

(Sure Al-Namal, ajet 89)

6. O njerëz! Nëse jeni në dyshim rreth Ringjalles, atëherë mbani mend se ne padyshim ju kemi krijuar nga dheu, mandej nga sperma, mandej nga embrioni, mandej nga një copë mishi-pjesërisht i formuar dhe pjesërisht i paformuar - me qëllim që t'jua tregojmë fuqinë Tonë. Dhe Ne e mbajmë në mitër atë që dëshirojmë (ta krijojmë) deri në një afat të caktuar. Mandej, Ne ju nxjerrim në formë të një foshnje; mandej ju zhvillojmë që të arrini moshën tuaj të pjekurisë. Dhe disa prej jush vdesin në moshën e tyre të natyreshme, ndërsa disa të tjerë e mbërrijnë moshën më të madhe të pleqërisë kështu që nuk dijnë gjë pjei asaj që kanë ditur. Dhe ti e sheh tokën se nganjëherë e humbas gjallërinë e saj, por kur në të e lëshojmë shiun, ajo merr hov dhe fillon të lulëzohet dhe mbin çdo lloj bimë të bukur.

(Sure Al-Haxh, ajet 6)

هُوَ الَّذِي يُصَوِّرُكُمْ فِي الْأَرْحَامِ كَيْفَ يَشَاءُ لَآ إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٧﴾ آل عمران: ٧

الَّذِي تَرَى الْجِبَالَ تَحْسَبُهَا جَامِدًا وَهِيَ تَمُرُّ مَرَّ السَّحَابِ صُنِعَ اللَّهُ الَّذِي لَذِي أَنْفَكُ كُلِّ شَيْءٍ إِنَّهُ خَيْرُ مَا تَفَعَّلُونَ ﴿٢٠﴾

ابراهيم: ٢٠

وَتَرَى الْجِبَالَ تَحْسَبُهَا جَامِدًا وَهِيَ تَمُرُّ مَرَّ السَّحَابِ صُنِعَ اللَّهُ الَّذِي لَذِي أَنْفَكُ كُلِّ شَيْءٍ إِنَّهُ خَيْرُ مَا تَفَعَّلُونَ ﴿٨٩﴾

النمل: ٨٩

يَتَأَيَّهَا النَّاسُ إِن كُنْتُمْ فِي رَيْبٍ مِّنَ الْبَعْثِ فَإِنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِّنْ تُرَابٍ ثُمَّ مِنْ نُطْفَةٍ ثُمَّ مِنْ عَلَقَةٍ ثُمَّ مِنْ مُضْغَةٍ مُخَلَّقَةٍ وَغَيْرِ مُخَلَّقَةٍ لِّنُسَبِّحَنَّ لَكُمْ وَنُنْقِرَنَّ فِي الْأَرْحَامِ مَا نَشَاءُ إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّى ثُمَّ نُخْرِجُكُمْ طِفْلًا ثُمَّ لِتَبْلُغُوا أَشَدَّكُمْ وَمِنْكُمْ مَّنْ يُؤَفِّقُ وَمِنْكُمْ مَّنْ يُرَدِّدْ إِلَىٰ أَزْدَلِ الْعُمُرِ لِكَيْلَا يَعْلَمَ مِنْ بَعْدِ عِلْمٍ شَيْئًا وَتَرَى الْأَرْضَ هَامِدَةً فَإِذَا أَنْزَلْنَا عَلَيْهَا الْمَاءَ اهْتَزَّتْ وَرَبَّتْ وَأَنْبَتَتْ مِنْ كُلِّ رَوْحٍ بِهِيجٌ ﴿٦﴾

الحج: ٦

VEZHGIMI LIDHUR ME NATYREN

9. Dhe Ai i ka krijuar kuajt dhe mushkat dhe gomarët që t'u hipni dhe si mjet zbukurimi. Dhe Ai do të krijojë (për ju) edhe në të ardhmën mjete transportimi, të cilat ju nuk i dini tash.

(Sure Al-Nahal, ajet 9)

2. I Bekuar është Ai Allah në dorën e të cilit është mbretëria dhe Ai ka fuqi mbi çdo gjë.

3. I cili e krijoi vdekjen dhe jetën që t'ju provojë se cili prej jush është më bimirës - dhe Ai është i Plotfuqishëm dhe shumë Mëkatfalës -

4. I cili krijoi shtatë qiej shkallë pas shkalle. Ti s'mund të shohësh ndonjë të metë në krijimin e Zotit të Mëshirshëm. Prandaj, vështro mirë e mirë duke e drejtuar shikimin tënd (andej e këndeje), a e sheh ndonjë të metë në të?

(Sure Al-Mulk 2-4)

وَالْحَيْلَ وَالْإِغَالَ وَالْحَمِيرَ لَتَرَكَبُوهَا وَزِينَةً
وَيَخْلُقُ مَا لَا تَعْلَمُونَ ﴿٩﴾

النحل: ٩

تَبْرَكَ الَّذِي يَدِيَهِ الْمُلْكُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢﴾

الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا
وَهُوَ الْعَزِيزُ الْعَفُورُ ﴿٣﴾

الَّذِي خَلَقَ سَبْعَ سَمَاوَاتٍ طِبَاقًا مَا تَرَى فِي خَلْقِ
الرَّحْمَنِ مِن تَفْوُوتٍ فَأَرْجِعِ الْبَصَرَ هَل تَرَى مِن
فُطُورٍ ﴿٤﴾

الملك: ٢ - ٤

DISA LUTJE QË NA MËSON KURANI I SHENJTË

Lutja është lidhje dinamike mes Zotit e të njerit të zotshëm. Mirësia e Zotit së pari e tërheq njeriun kah Ai. Zoti iu afrohet atij, i cili tregon mirënjohje dhe sinqeritetin ndaj Tij. Në lutje kjo marrëdhënie arrin kulmin e saj dhe krijon konsekuencat speciale. Ata, të cilët dinë rreth eksperiencave shpirtërore dhe mbërritjeve, dinë - dhe dinë me anë të eksperiencave të përsëritura - se një besimtar përfekt mund të ketë fuqinë kreative nëpër mes lutjes.

187. Dhe kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, thuaju: Unë jam afër, i përgjigjem lutësit kur ai Më thërret Mua. Pra, duhet që edhe ata (lutësit) t'Më përgjigjen (i pranojnë urdhërat e Mía) dhe duhet t'Më besojnë Mua që të përudhen ata.

202. Dhe ka prej tyre që thonë! O Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë dhe të mira në botën tjetër dhe na ruaj prej ndëshkimit të Zjarrit!

203. Të tillë janë ata që e kanë një pjesë të madhe nga ai sevab që fituan ata. Vërtetë, Allahu është i Shpejtë në qërimin e hesapit.

287. Allahu nuk e ngarkon njeriun përtej kapacitetit të tij. Atij do t'i takojë dobia e asaj që ka fituar ai dhe e kaqja (e asaj që bëri ai) i bie atij. O Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë! O Zoti ynë, mos na ngarko neve me barrë të rëndë siç i ngarkove ata që ishin para nesh! O Zoti ynë, mos na ngarko me atë (barrë) për të cilën ne nuk kemi fuqi (ta ngarkojmë)! Dhe

وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ
أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ فَلْيَسْتَجِيبُوا
لِي وَلْيُؤْمِنُوا بِلِعَالَمِهِمْ يَرْشُدُونَ ﴿٢٨٧﴾

البقرة: ٢٨٧

وَمِنْهُمْ مَن يَقُولُ رَبَّنَا إِنَّا فِي الدُّنْيَا
حَسَنَةٌ وَفِي الآخِرَةِ حَسَنَةٌ وَقِنَا عَذَابَ
النَّارِ ﴿٢٠٢﴾

أُولَئِكَ لَهُمْ نَصِيبٌ مِّمَّا كَسَبُوا وَاللَّهُ سَرِيعُ
الْحِسَابِ ﴿٢٠٣﴾ البقرة: ٢٠٢ - ٢٠٣

لَا يَكْفُرُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا أَوْسَعَهَا لَهَا مَا
كَسَبَتْ وَعَلَيْهَا مَا اكْتَسَبَتْ رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا
إِن نَسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا رَبَّنَا وَلَا تَحْمِلْ
عَلَيْنَا أَصْرًا كَمَا حَمَلْتَهُ عَلَى الَّذِينَ مِن
قَبْلِنَا رَبَّنَا وَلَا تُحَمِّلْنَا مَا لِإِطَاقَةِ لَنَا بِهِ

DISA LUTJE QE NA MESON KURANI I SHENJTE

na fal neve dhe na i shley mëkatet e gabinet tona dhe mëshirona! Ti je Zoti ynë, na ndihmo kundër popullit mosbesimtar!

(Sure Al-Bakara, 187,202,203 dhe 287)

191. Vërtetë, në krijimin e qiejve e të tokës dhe në ndryshimin e natës dhe të ditës ka Shenja të hapura për njerëzit intelektual -

192. Të cilët e përkujtojnë Allahun duke qëndruar në këmbë, duka u ulur e kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve dhe të tokës dhe thonë: 'O Zoti ynë, këtë (univers) nuk e ke krijuar pa qëllim, I Lartë je Ti, ruajna prej ndëshkimit të Zjarrit!

193. O Zoti ynë, atë të cilin e fut Ti në Zjarr, atë e ke poshtëruar. Dhe për mizorët nuk do të jetë asnjë ndihmtar.

194. O Zoti ynë, ne kemi dëgjuar zërin e një thirrësi që na fton kah besimi dhe që na thotë: 'Besoeni Zotin tuaj! Pra, ne e pranuan besimin. Zoti ynë, na fal mëketet tona dhe na shley gabimet tona dhe na jep vdekjen me bamirësit (duke na numëruar ndër bamirësit)!

195. O Zoti ynë, jepna atë që na premtove neve me anë të Profetëve Tu; dhe mos na poshtëro neve në Ditën e Kiametit! Vërtetë, Ti nuk e shkel premtimin Tënd!

196. Pra, Zoti i tyre i dëgjoi lutjet e tyre duke thënë: Unë nuk do t'ia humb mundin (punën) e asnjërit prej jush qoftë është mashkull apo është femër. Ju keni lidhje me njeri-tjetrin. Pra, ata që emigruan dhe që u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe u torturuan në rrugën Time dhe të cilët luftuan dhe u vranë, Unë do t'i shley mëkatet e tyre dhe do t'i fus në ato Kopshte ku po rrjedhin rrëketë - ky do të jetë shpërblim nga ana e Allahut dhe shpërblimi më i mirë është te Allahu.

(Sure Al-Imran, ajete 191-196)

وَأَعْفُ عَنَّا وَاعْفِرْ لَنَا وَارْحَمْنَا أَنْتَ مَوْلَانَا

فَأَنْصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ ﴿١٨٧﴾

البقرة: ٢٨٧

إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافِ

الَّيْلِ وَالنَّهَارِ لآيَاتٍ لِأُولِي الْأَلْبَابِ ﴿١٩١﴾

الَّذِينَ يَذْكُرُونَ اللَّهَ قِيَمًا وَقُعُودًا وَعَلَىٰ جُنُوبِهِمْ

وَيَتَفَكَّرُونَ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ رَبَّنَا مَا

خَلَقْتَ هَذَا بَطْلًا سُبْحَانَكَ قِنَاعَ عَادَابِ النَّارِ ﴿١٩٢﴾

رَبَّنَا إِنَّكَ مَنْ تَدْخِلِ النَّارَ فَقَدْ أَخْرَجْتَهُ وَمَا

لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ ﴿١٩٣﴾

رَبَّنَا إِنَّا أَسْمَعُ مَا نَدِينَا بِدَىٰ لِلْإِيمَانِ أَنْ ءَامِنُوا

بِرَبِّكُمْ فَمَا مَنَّا رَبَّنَا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَكَفِّرْ عَنَّا

سَيِّئَاتِنَا وَتَوَفَّنَا مَعَ الْأَبْرَارِ ﴿١٩٤﴾

رَبَّنَا وَإِنَّا مَاعِدَتْنَا عَلَىٰ رَسُولِكَ وَلَا نُخْرِجُنَا يَوْمَ

الْقِيَمَةِ إِنَّكَ لَا تُخْلِفُ الْمِعَادَ ﴿١٩٥﴾

فَأَسْتَجَابَ لَهُمْ رَبُّهُمْ أَنِّي لَا أُضِيعُ عَمَلَ

عَمَلٍ مِنْكُمْ مِنْ ذَكَرٍ أَوْ أَنْتِي بَعْضُكُمْ مِنْ بَعْضٍ

فَالَّذِينَ هَاجَرُوا وَأُخْرِجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ وَأُودُوا

فِي سَبِيلِي وَقَاتَلُوا وَقُتِلُوا لَأُكَفِّرَنَّ عَنْهُمْ

سَيِّئَاتِهِمْ وَلَأُدْخِلَنَّهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرَىٰ مِنْ

تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ثَوَابًا مِنْ عِنْدِ اللَّهِ وَاللَّهُ عِنْدَهُ

حُسْنُ الثَّوَابِ ﴿١٩٦﴾ آل عمران: ١٩١ - ١٩٦

DISA KAPTINA TE VOGLA

TE KURANIT TE

1. Në emër të Allahut të Mëshirëshem e të Dhembshueshm

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿١﴾

2. E paraqes për dëshmi epokën (e profetit të shenjtë),

وَالْعَصْرِ ﴿٢﴾

3. Më të vërtetë, njeriu (kundërshtar i profetëve të Zotit) gjithmonë është në humbje,

إِنَّ الْإِنْسَانَ لِفِي خُسْرٍ ﴿٣﴾

4. Pos atyre, të cilët e pranojnë besimin dhe bëjnë vepra të mira dhe ia japin njeri-tjetrit nxitje për të qëndruar mbi bazat e vërtetësisë dhe ia japin njeri-tjetrit nxitje për ta shprehur qëndrimin (ndaj vërtetësisë).

إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَاصَوْا

بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ ﴿٤﴾ العصر: ١ - ٤

(Sure Al-Asr, ajët 1-4)

1. Në emër të Allahut të Mëshirëshëm dhe të Dhembshueshm

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿١﴾

2. Thuaju, ti mysliman, O ju mosbesimtarë, dëgjoni,

قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ ﴿٢﴾

3. Unë nuk e adhuroj atë, të cilin e adhuron ju,

لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ ﴿٣﴾

DISA KAPTINA TE VOGLA TE KURANIT TE

4. As ju nuk e adhuroni Atë, të cilin e adhuroj unë,

وَلَا أَنْتُمْ عِبِدُونَ مَا أَعْبُدُ ﴿٤﴾

5. As nuk e adhuroj ata (idhujt), të cilët i adhuroni ju,

وَلَا أَنَا عَابِدٌ مَّا عَبَدْتُمْ ﴿٥﴾

6. As nuk e adhuroni ju Atë (Allahun), të cilin e adhuroj unë,

وَلَا أَنْتُمْ عِبِدُونَ مَا أَعْبُدُ ﴿٦﴾

7. Ju keni fenë tuaj, kurse unë kam fenë time.

لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ ﴿٧﴾

(Sure Al-Kaferun, ajete 1-7)

الكافرون ١ - ٧

1. Në emër të Allahut të Mëshirëshëm dhe të Dhembshueshëm

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿١﴾

2. Kur do të vijë ndihma e Allahut dhe fitorja,

إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ ﴿٢﴾

3. Dhe ti do t'i shohësh njerëzit duke hyrë grupe-grupe në religjionin e Allahut,

وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَنْفَاجًا ﴿٣﴾

4. (Atëherë) Glorifikoe Zotin tënd me lavdrimin e Tij dhe kërkoe faljen e Tij (për gabimet e myslimanëve). Vërtetë, Ai është shumë metani-pranues.

فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَأَسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا ﴿٤﴾

النصر: ١ - ٤

(Sure Al-Nasr, ajete 1-4)

1. Në emër të Allahut të Mëshirëshëm dhe të Dhembshueshëm

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿١﴾

2. Thuaj, Allahu është Një.

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ﴿٢﴾

3. Allahu është i Pavarur (kur të gjithë varen prej Tij).

اللَّهُ الصَّمَدُ ﴿٣﴾

4. Ai nuk e ka lindur askënd e as nuk është i lindur Ai.

لَمْ يَكُنْ لَكَ يُولَدٌ وَلَمْ يُولَدْ ﴿٤﴾

5. Dhe askush nuk i përngjet Atij (në atributet e Tij).

وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ ﴿٥﴾

(Sure Al-Ikhlâs, ajete 1-5)

الإخلاص: ١ - ٥

DISA KAPTINA TE VOGLA TE KURANIT TE

1. Në emër të Allahut të Mëshirëshëm dhe të Dhembshueshëm

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿١﴾

2. Thuaj, Unë kërkoj strehim tek te Zoti i krijesave,

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ﴿٢﴾

3. Nga e keqja që e ka krijuar Ai,

مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ ﴿٣﴾

4. Dhe prej sherrit të terrsjellësit kur e shpërndan terrin,

وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ ﴿٤﴾

5. Dhe prej sherrit të gjithë atyre, të cilët krijojnë ngatërrimet në mes njerëzve,

وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ ﴿٥﴾

6. Dhe prej sherrit të çdo njeri xheloz kur e shfaq xhelozinë.

وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ ﴿٦﴾

(Sure Al-Falak, ajete 1-6)

الفلق: ١ - ٦

1. Në emër të Allahut të Mëshirëshëm dhe të Dhembshueshëm

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿١﴾

2. Thuaj, Unë kërkoj strehimin e Zotit të njerëzve,

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ ﴿٢﴾

3. Që është Mbret i njerëzimit,

مَلِكِ النَّاسِ ﴿٣﴾

4. Dhe është edhe Zoti i njerëzimit,

إِلَهِ النَّاسِ ﴿٤﴾

5. Prej sherrit të çdo njeri pëshpëritës që fshehet, pasi që helmon zemrën e njeriut;

مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ ﴿٥﴾

6. I cili fut huti në zemret e njerëzve,

الَّذِي يُوسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ ﴿٦﴾

7. Prej xhindëve e prej njerëzve!
(Sure Al-Nas, ajete 1-7)

مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ ﴿٧﴾

الناس: ١ - ٧